



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 506 Prot.

Tiranë, më 07/04/2020

Lënda: Rekomandim për zgjerimin e subjekteve që hyjnë në kategorinë e shtresave në nevojë të përcaktuara në pikën 4 të VKM-së nr. 236, datë 19.03.2020.

KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Adresa: Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”
TIRANË

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si institucion i pavarur publik, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “f”, të Ligjit Nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”.

Në përbushje të qëllimit të Ligjit 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim referohet Komisioneri ose KMD), parashtron sa më poshtë vijon:

1. Përpala institucionit të Komisionerit është paraqitur ankesa nr. 22, datë 25.03.2020, e bërë nga organizata: “Qendra për Advokim Social” kundër Këshillit të Ministrave, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike dhe familjare”.
2. Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, parashtron situaata si më poshtë:

- Nisur nga situata e vështirë në të cilën ndodhet Shqipëria nga përhapja e virusit COVID-19, organizata “Q.A.S” është informuar nga familjet e varfëra që gjatë 12 ditëve të karantinës në disa qytete të Shqipërisë nuk janë shpërndarë pako mjaftueshmë për familjet e varfëra për shërbimet bazë siç janë: ushqime, detergjend dhe medikamente. Nisur nga kjo situatë, familjet e varfëra, kryesisht të përfaqësuara nga komuniteti rom dhe egjiptian kanë reaguar duke u mobilizuar me njeri tjetrin, duke zhvilluar protesta¹ në qytetet e tyre me thirrjen për t’iu siguruar ushqimi bazë nga ana e institucioneve, pasi situata e krijuar ka lënë këto familje në pamundësi për të kryer punën informale të përditshme siç është: mbledhja e mbetjeve të riciklueshme, tregëtimi i rrobave të përdorura, mbledhja e skrapit, etj. Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 236, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” por familjet të cilat sigurojnë të ardhurat përmes punës informale nuk e gjejnë veten të mbështetur në kategoritë e përcaktuara në këtë vendim, për rrjedhojë ata nuk mund të përfitojnë ndihma nga shërbimet e ofruara nga institucionet shtetërore. Nevojitet që pjesë të këtij vendimi të jenë dhe familjet e varfëra, të cilët janë punëkërkues të papunë, që për arsyeb objektive nuk kanë arritur që t’iu sigurohet një punë nga institucionet shtetërore. Aktualisht këto familje ushtrojnë informalisht aktivitetet e sipërpërmendura

I. Bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlereson:

Mbrojtja e shtresave në nevojë dhe gjëzimi i të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim garantonohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 18 i Kushtetutës së RSH-së sanksionon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tillë si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kreu i IV i Kushtetutës vë theksin tek liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat duhet të gjëzohen de facto, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Komuniteti rom dhe egjiptian në Shqipëri përballet me situata shumë të vështira për sa i përket çështjes së punësimit, çështje kjo e ngritur dhe nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit 2019, në të cilin shkruhet se: “*Pjesëmarrja e përgjithshme e punësimit dhe fuqisë punëtore tek komuniteti Rom mbeten shumë e ulët (mbi 56% e romëve në moshë pune janë të papunë). Punësimi informal midis romëve përbën 62% të të punësuarve të komunitetit rom²*”.

¹ <https://oranews.tv/article/romet-ne-durres-proteste-ushqim-firma-private-u-shperndan-buke-falas>,
<https://tvklan.al/covid-19-romet-ne-proteste-ne-durres/>, - <https://boldnews.al/2020/03/26/video-vlore-fier-e-durres-protest-a-per-ndihmen-ekonomike-ja-efare-i-kerkojne-rames/>

² Progres Raporti 2019, fq. 31, përkthim i Komisionerit.

Gjendja e vështirë e komunitetit rom dhe egjiptian njihet dhe nga qeveria e Republikës së Shqipërisë e cila me VKM nr.1072, datë 23.12.2015 ka miratuar “Planin Kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020” në të cilën shkruhet: “Romët dhe egjiptianët përballen me barriera të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta në aksesin e shërbimeve publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t'i plotësojnë, nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjeter e popullatës. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së romëve dhe egjiptianëve, në trajtimin nga pjesa tjeter e popullatës dhe në marrëdhënien me institucionet shtetërore. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë në radhët e komunitetit rom është dy herë më i lartë se në pjesën tjeter të popullatës, ndërsa niveli i papunësisë është tre herë më i lartë se mesatarja. Për shkak të periudhave të gjata të papunësisë dhe angazhimit të shpeshtë në punë informale dhe me pagë të ulët, familjet rome preken nga varfëria mbi dy herë më shumë sesa familjet jo-rome që jetojnë në qëndrën e tyre. Romët që arrijnë të gjejnë punë merren kryesisht me tregti të vogla të dorës së dytë dhe mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme³”.

Në kuadër të trajtimit të pretendimit të mësipërm, Komisioneri analizoi legjislacionin përkatës, me qëllim që të evidentohet nëse është cënuar kategoria e personave që janë të punësuar në mënyrë informale dhe që merren kryesisht me grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme, tregëtimin e rrobave të përdorura, mbledhjen e skrapit, etj.

Në pikën 4 të VKM-së nr. 236, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, janë parashikuar se kush do të konsiderohen si shtresa në nevojë, dhe përcaktohet se:

Në kuptim të këtij vendimi, shtresa në nevojë do të konsiderohen:

- a) personat/familjet, të cilët nuk kanë familjarë të aftë për punë në njësinë administrative ku jetojnë, dhe që bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon:
 - i. Familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike;
 - ii. Personat me aftësi të kufizuara;
 - iii. Personat, të cilët përfitojnë pension pleqërie.
- b) personat, të cilët, pavarësisht përbërjes familjare dhe vendndodhjes së saj, bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon:
 - i. Familjet/individët në nevojë, të cilët janë të pastrehë;
 - ii. Familjet që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit.

Ky akt nënligjor është një masë e ndërmarrë nga qeveria e Republikës së Shqipërisë lidhur me situatën e krijuar në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19 për përbushjen e

³ Statistikat për komunitetin rom dhe egjiptianët i referohen: “Planit kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020” miratuar me VKM nr.1072, datë 23.12.2015, fq. 4, 11 dhe 12.

detyrimeve nga ana e shtetit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive, si dhe masat që duhet të marrin strukturat shtetërore për ofrimin e asistencës për shtresat në nevojë.

Komisioneri vlerëson se, vendimi i Këshilli i Ministrave, i cili përcakton shtresat në nevojë dhe ofrimin e asistencës në banesë për këto shtresa nga ana e strukturave shtetërore, është në tërësinë e tij pozitiv.

Gjithashtu, KMD shpreh mirëkuptimin e tij që informaliteti është paligjshmëri dhe për rrjedhojë krijon padjeni dhe probleme sociale dhe ekonomike në vendin tonë. Nga ana tjeter ai është një realitet dhe prek shumë qytetarë në Republikën e Shqipërisë, të cilët tashmë ndodhen në pamundësi për të siguruar mjetet e tyre thelbësore të jetesës në këtë periudhë kur është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.

Nisur nga këto premisa:

Së pari, në analizë të pikës 4 të VKM-së nr. 236, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, Komisioneri vlerëson se kategoria e personave që merren me punë informale si, mbledhja e mbetjeve të riciklueshme, tregëtimi i rrobave të përdorura, mbledhja e skrapit, etj, nuk janë konsideruar si shtresë në nevojë, dhe për këtë arsy, ato nuk përfitojnë ndihma ushqimore dhe shëndetësore për kalimin e situatës së krijuar.

Për këtë arsy, Komisioneri vlerëson se një pjesë e këtyre personave mund të identifikohen si kategoria e personave që janë punëkërkues të papunë, të cilët nuk kanë qenë më parë të punësuar dhe për pasojë nuk kanë kontribuar në skemën e sigurimit shoqëror sipas nenit 53 të Ligjit 7703 datë 11/05/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSh”, i ndryshuar,

Gjithashtu, Komisioneri sugjeron që të konsultohen listat e familjeve dhe personave, që gjatë vitit 2018 kanë qenë pjesë e listës së personave që trajtoheshim me ndihmë ekonomike dhe gjatë vitit 2019 janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike.

Së dyti, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon krijimin e lehtësive për personat që nuk janë deri aktualisht të regjistruar si punëkërkues të papunë, me qëllim krijimin e mundësisë për përfshirjen e kësaj kategorie gjithashtu, si subjekte përsituese të asistencës, në zbatim të VKM Nr. 236, datë 19.03.2020.

Kështu, referuar Ligjit 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”, punëkërkuesit që deklarojnë në strukturën përkatëse, që nuk janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar dhe që janë të gatshëm menjëherë për punësim, t'u krijohet mundësia e regjistrimit si “Punëkërkues i papunë”, në koordinim me institucionet e tjera publike, në mënyrë që të shmangen pagesat e dyfishta, dhe, nëse eshtë e mundur me një procedurë të përshtapshuar.

Sa më lart, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

REKOMANDON:

Marrjen e masave, për përfshirjen në pikën 4 të VKM-së nr. 236, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, sipas përbajtjes së këtij Rekomandimi, me qëllim:

1. Përfshirjen e kategorisë së personave që janë punëkërkues të papunë, të cilët nuk kanë qenë më parë të punësuar dhe për pasojë nuk kanë kontribuar në skemën e sigurimit shoqëror sipas nenit 53 të Ligjit 7703 datë 11/05/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSh”, i ndryshuar.
2. Krijimin e lehtësive për personat që nuk janë deri aktualisht të regjistruar si punëkërkues të papunë, me qëllim krijimin e mundësisë për përfshirjen e kësaj kategorie gjithashtu, si subjekte përfituese të asistencës, në zbatim të VKM Nr. 236, datë 19.03.2020.

Lutemi përcjelljen e informacionit mbi veprimet e ndërmarra nga ana Juaj, për zbatimin e këtij rekomandimi, brenda një afati sa më të arsyeshëm.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,

KOMISIONER



Robert GAJDA

